



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, dhe nenit 14, paragrafi 14.1 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 10, paragrafi 1.4, të Ligjit nr. 04/L -144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17, dhjetor 2012), të nenit 20 paragrafi 3, nënparagrafi 3.3 të Rregullores së QRK-së, nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 05.02.2019, merr këtë

V E N D I M

PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS

- I.** MIRATOHET propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim Bashkësisë Islame të Kosovës.
- II.** Prona e paluajtshme që do të jepet në shfrytëzim, ka këto karakteristika: nga parcela nr P-71914059-0691-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 14877m² merret në shfrytëzim sipërfaqja prej 53m², nga parcela nr P-071914059-0692-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 7170m² merret në shfrytëzim sipërfaqja prej 352m², nga parcela nr P-071914059-0694-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 6174m² merret në shfrytëzim sipërfaqja prej 245m² dhe nga parcela nr P-071914059-0696-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 7466m² merret në shfrytëzim sipërfaqja prej 237m², Zona kadastrale Prishtinë, me sipërfaqe të përgjithshme të objektit prej 887m².
- III.** Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij vendimi, është dhënia e objektit në shfrytëzim Bashkësisë Islame të Kosovës për ushtrimin e aktivitetit të tyre.
- IV.** Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij vendimi, është afatgjatë, në periudhën kohore deri në 99 vjet.
- V.** Prona e paluajtshme e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim.



- VI.** Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.
- VII.** Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastrale të Komunës.
- VIII.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe drejtoritë kompetente të Komunës së Prishtinës.
- IX.** Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
- kërkesa,
 - skica grafike,
 - fleta poseduese,
 - kopja e planit për parcelat kadastrale, nr. 691-0, nr. 692-0, nr. 694-0, dhe nr. 696-0, Zona kadastrale Prishtinë.
- X.** Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administratës të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/01-0026705/19, më 06.02.2019

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

